



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10

Prishtinë

10000

Republika e Kosovës

T/F: +381 38 746 206

E-mail: ridea.institute@gmail.com

Website: www.ridea-ks.org

RAPORTI

Perceptimi i opinionit publik mbi procesin e integritit Evropian

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Konteksti	7
2. Metodologjia.....	9
2.1. Dizajni i sondazhit.....	9
2.2. Procedura e sondazhit	9
2.3 Mostra	10
2.4. Analiza dhe prezantimi i të dhënave.....	11
2.5. Karakteristikat e mostrës	11
3. Të gjeturat	14
4. Konkluzionet dhe rekomandimet	42
Aneksi 1: Pyetësi.....	47

Ky hulumtim është bërë i mundur me kontributin e projektit "MSA dhe ngritja e vetëdijes publike rreth liberalizimit të vizave", i financuar bashkërisht nga Ministria e Integritit Evropian dhe UNDP Kosovë.

Të gjeturat dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin qëndrimet zyrtare të të dy organizatave.

Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
PNZMSA	Programi nacional për zbatimin e MSA
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport pasqyron rezultatet e sondazhit: Perceptimi i opinionit publik për procesin e integrit Evropian që është kryer gjatë periudhës: 22 gusht deri më 15 shtator 2016, në 7 rajonet kryesore të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj. Qëllimi i këtij hulumtimi është që: a) të identifikojë perceptimin e opinionit publik mbi procesin e integrit Evropian; b) të identifikojë perceptimin e opinionit publik për MSA (Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit); dhe c) të identifikojë perceptimin e opinionit publik mbi procesin e liberalizimit të vizave.

Anketa është kryer në një mostër prej 1000 të anketuarve. Mostra është përzgjedhur përmes mënyrës propocionale të thjeshtë. Anketa është implementuar nëpërmjet pyetësorit të përpiluar, i cili është administruar në shtëpitë e të anketuarve dhe apartamente. Pyetësi është i përbërë nga 16 pyetje në seksionet e mëposhtme: të dhënat demografike rreth pjesëmarrësve, njohuritë e tyre në dhe të kuptuarit e procesit të integrit Evropian, njohuritë e tyre për MSA-në dhe njohuritë e tyre si dhe perceptimin e procesit të liberalizimit të vizave. Fillimisht, ekipi i sondazhit ka administruar pyetësin në një grup pilot prej 30 të anketuarve. Koeficienti i besueshmërisë së pyetësorit është 0.82. 53% të të anketuarve ishin meshkuj kurse 47% ishin femra. Moshë mesatare e të anketuarve në mostër është 36.4 vjet. Ky sondazh tregon se koncepti i integrit Evropian është i njohur për shumicën e të anketuarve, përkatësisht, për 84.6% prej tyre. Sondazhi gjithashtu tregon se shumica e të anketuarve, dmth banorët e Kosovës, marrin informacion në lidhje me integrimin Evropian në lajmet televizive, portale dhe media të tjera të shkruara. Sondazhi tregon se ka një dallim në të kuptuarit e konceptit të integrit Evropian. 33.5% e të anketuarve e kuptojnë integrimin Evropian si: një bashkim, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore; 29.6% e tyre e kuptojnë integrimin Evropian si: një proces ekonomik që shmang konfliktet midis vendeve që janë anëtare të Unionit dhe promovon paqe si dhe marrëdhënie të mira mes vendeve fqinje; dhe 25.9% e tyre e kuptojnë integrimin

Evropian si: një integrim i shoqërisë kosovare në një bashkim që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale.

Për më tepër, ky sondazh gjen se shumica e të anketuarve perceptojnë se Kosova do të përfitojë nga procesi i integrimit Evropian. Ata shprehin përfitimet e mëposhtme: zhvillim ekonomik; lëvizje të lirë; tregti më të lehtë; punësim në BE; shkëmbim në arsim, zhvillim të rinjve dhe zhvillim kulturor. Përveç kësaj, numri i moderuar i të anketuarve nga 6 rajonet e Kosovës kanë shprehur se integrimi Evropian mund të shihet si një metodë për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërtën, në rajonin e Mitrovicës, numri i madh i të anketuarve të etnisë shqiptare percepton se procesi i integrimit Evropian nuk do të çojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Përveç kësaj, numri i moderuar i të anketuarve nga 6 rajonet e Kosovës janë shprehur që integrimi Evropian mund të shihet si një metodë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe vendit fqinj Serbisë. Në të kundërtën, në rajonin e Mitrovicës, numri i madh i të anketuarve shqiptar etnik percepton se procesi i integrimit Evropian nuk do të çojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në të gjitha rajonet e Kosovës, të anketuarit janë shprehur se procesi i integrimit Evropian është duke u zhvilluar me një ritëm të ngadaltë. Për më tepër, anëtarësimi i Kosovës në BE është perceptuar si një metodë e moderuar për çështjet ekonomike të Kosovës dhe më pak për sfidat e saj politike.

Një numër mesatar i të anketuarve janë të vetëdijshëm që Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA). Megjithatë, vetëm rreth 30% e të anketuarve të cilët janë të vetëdijshëm për nënshkrimin e MSA-së, kanë shprehur që Kosova mund të ketë përfitime nga MSA. Edhe për këtë, lajmet në TV, shfaqen si mjet kryesor i marrjes së informatës për MSA.

Gjithashtu, më shumë se 60% e të anketuarve perceptojnë saktë procesin e liberalizimit të vizave; dhe 78.9% të saktë perceptojnë kohëzgjatjen e qëndrimit në vendet e zonës Schengen nëpërmjet procesit të liberalizimit të vizave. Megjithatë, 20% e të anketuarve të papunë, në krahasim me 8% e të anketuarve

të punësuar, e perceptojnë procesin e liberalizimit të vizave si një metodë për të gjetur punë në vendet e BE-së.

Në përgjithësi, ky sondazh ka gjetur se opinionit publik në Kosovë është i vetëdijshëm për konceptin e integritit Evropian. Megjithatë, ka dallime në të kuptuarit dhe interpretimin e këtij koncepti. Gjithashtu sondazhi tregon se të anketuarit perceptojnë se procesi i integritit Evropian i Kosovës është i lidhur pozitivisht me zhvillimin e ekonomik. Përveç kësaj, anëtarësimi i Kosovës në BE është perceptuar të jetë më e lidhur me zhvillimin ekonomik në vend se me tejkalimin e sfidave aktuale politike të Kosovës.

Lajmet në televizion duket të jenë një nga metodat përmes të cilës të anketuarit marrin informacion mbi integritin Evropian dhe MSA-së. Ky sondazh ka identifikuar se procesi i liberalizimit të vizave dhe komponentëve të tij janë të perceptuar në mënyrë të drejtë. Megjithatë, ekziston një perceptim pak më i ndryshëm i të anketuarve të papunë ndaj liberalizimit të vizave; të cilët kanë tendencë për të parë atë si një mundësi për t'u punësuar në vendet e BE.

Së fundi, ky raport përmban analizën e detajuar të të dhënave, konkludimet kryesore të sondazhit si dhe rekomandimet për hapat e mëtejshëm.

1. Konteksti

Sondazhi është kryer në periudhën nga 22 gusht deri më 15 shtator 2016. Objektivi i përgjithshëm i projektit " MSA-së dhe ndërgjegjësimi i publikut për liberalizimin e vizave" është që të promovojë integrimin Evropian dhe të rrisë ndërgjegjësimin në mesin e qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës në aspekte të ndryshme të procesit, veçanërisht në procesin e liberalizimit të vizave.

Kosova është në proces të konsolidimit të sistemeve të brendshme, strukturave dhe institucioneve të saja të qeverisjes. Ka kaluar në një seri të proceseve që janë themelore për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të ardhmen e tyre. Këto procese nuk janë të lidhura vetëm me dizajnimin e duhur dhe funksionimin efektiv të strukturave të autoritetit dhe kontrollit, por edhe me sistemin e vlerave apo të rezultateve të dëshiruara. Në veçanti këto procese kanë të bëjnë me sistemin e mirëqenies dhe të bashkëpunimit rajonal dhe/ose ndërkombëtar, sigurisë dhe stabilitetit. Ndërlidhja në mes të njerëzve dhe problemeve, që është gjithnjë në rritje, kërkon vëmendje dhe veprime të veçanta për çështjet që tejkalojnë kufijtë kombëtar.

Në këtë kontekst, përfundimi i negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) midis Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës, në korrik 2014, dhe nënshkrimin e saj në nëntor të vitit 2015, shënoi një moment historik në rrugën e integritit Evropian të Kosovës, duke përfaqësuar marrëveshjen e parë gjithëpërfshirëse mes BE-së dhe Kosovës. Kjo marrëveshje përcaktoi drejtimin e Kosovës në rrjedhën e marrëdhënieve të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe konfirmoi perspektivën Evropiane të Kosovës në kuadër të kriterëve të Kopenhagës 1993. Në përgatitje për hyrjen formale në fuqi të MSA-së, në dhjetor të vitit 2015, Kosova ka miratuar po ashtu Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA).

Propozimi i 4 Majit 2016, nga Komisioni i BE-së për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës, në mënyrë që qytetarët e saj të jenë në gjendje të udhëtojnë lirshëm brenda kufijve të zonës Schengen në Evropë, është një hap tjetër pozitiv për Kosovën. Ky është një rezultat i drejtpërdrejtë i angazhimit të

Kosovës për të përmbushur të gjitha rekomandimet për liberalizimin e vizave, që përfshin, përmirësimin e kontrolleve kufitare, futjen e pasaportave biometrike, si dhe zbatimin e programit të kthimit dhe riintegrimi. Avantazhet e liberalizimit të vizave përfshijnë lëvizjen e lirë të njerëzve, e cila ofron qasje në njohuri, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave, si brenda rajonit dhe në BE, formësimin e drejtpërdrejt të bashkëpunimit në të gjitha segmentet e shoqërisë të Evropës Juglindore (EJL).

MSA dhe liberalizimi i vizave nuk janë procese të reja por janë të reja për Kosovën. Këto dy procese prekin shoqërinë, në nivel individual ose organizativ duke përfshirë edhe strukturat drejtuese. Si e tillë është e nevojshme që informacionet mbi kërkesat dhe përfitimet e këtyre dy proceseve, të jepen në kohë dhe të qarta për qytetarët, komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, duke përfshirë edhe qarqet akademike. Në të gjitha rastet, ka vetëdije të kufizuar të bizneseve në kërkesat dhe përfitimet e dispozitave të MSA-së në fushat e lidhura me tregtinë dhe tregun e brendshëm, duke përfshirë edhe institucionet publike, shoqërinë civile, mediat dhe aktorët e tjerë, në fushën e standardeve të BE-së dhe politikave të bashkëpunimit.

Prandaj, objektivat e sondazhit, “Perceptimet e opinionit publik për procesin e integritit Evropian” ishin:

1. Identifikimi i perceptimit të opinionit publik mbi procesin e integritit Evropian
2. Identifikimi i perceptimit të opinionit publik mbi MSA-në (Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit)
3. Identifikimi i perceptimit të opinionit publik mbi procesin e liberalizimit të vizave

2. Metodologjia

2.1. Dizajni i sondazhit

Dizajni i sondazhit është bazuar në pyetësin e administruar në këtë fushë. Pyetësi përbëhet nga 16 pyetje dhe nga seksionet e mëposhtme: të dhënat demografike rreth pjesëmarrësve, njohuritë e tyre në dhe të kuptuarit e procesit të integritit Evropian, njohuritë e tyre mbi MSA si dhe njohuritë dhe perceptimi i tyre në procesin e liberalizimit të vizave. Pyetësi përbëhet nga pyetje të hapura dhe të mbyllura. Pyetësi i administruar ka matur opinionet dhe perceptimet e pjesëmarrësve, ndërsa ata gjithashtu kanë pasur mundësinë të shprehin hapur perceptimet e tyre me anë të pyetjeve të hapura.

Kryesisht, pyetësi ka qenë aplikuar në një pilot grup i përbërë nga 30 të anketuar. Koeficienti besueshmërisë të pyetësit në pilot grup është 82. Pas analizimit të të dhënave të mbledhura përmes pilot grupit, ekipi hulumtues nuk ka bërë asnjë ndryshim në verzionin përfundimtar të pyetësit.

2.2. Procedura e sondazhit

Ekipi i sondazhit përbëhet nga 14-18 intervistuesit në terren dhe 3 hulumtues, ekspertit kryesor dhe bashkëhulumtuesit. Ekipi i sondazhit brenda Institutit RIDEA fillimisht ka trajnuar intervistuesit në terren për çështjet si: qëllimin e sondazhit, përmbajtjen e pyetësit dhe mënyrat e administrimit të pyetësit në terren. Pyetësi nuk ishte i vetë-administruar, megjithatë intervistuesit në terren e plotësuan atë. Kjo siguroi që të mos mungonin të dhënat, veçanërisht pasi që mostra është përbërë nga kategori të ndryshme të popullsisë për sa i përket nivelit të arsimit.

Për të kontrolluar saktësinë e intervistuesve, gjatë mbledhjes të të dhënave, rreth 20% (një total prej 200) e të anketuarve u ri-intervistuan. Ky rikonfirmim i të dhënave është bërë përmes vizitave në terren (30%), përkatësisht 60 vizitave në terren, dhe 140 intervistave telefonike (70%). Intervista e dytë u krye në përputhje me listen/regjistri që përmbante më së paku 5 pyetje nga origjinali i

intervistës. Lista e pyetjeve ka shërbyer si një mjet i rishikimit të përputhshmërisë me parimin e lokalitetit të rastit, pikënisjen, njësinë e shtëpisë, dhe parimin e zgjedhjes së anketuarit. Përgjigjet nga intervista e parë dhe dytë janë krahasuar. Përveç procesit të zakonshëm të kontrollit, u krye edhe një rikontrollim logjik i pyetësorëve të plotësuar.

2.3 Mostra

Hulumtimi është kryer në 38 komuna të Kosovës, në të 7 rajonet kryesore të Kosovës: Prishtinë / Priština, Ferizaj / Uroševac, Gjilan / Gnjilane, Prizren, Pejë / Peć, Gjakovë / Đakovica dhe Mitrovica (Veriut dhe Jugut). Kosova ka një popullsi prej 1.739.825 banorë. Në këtë sondazh, mostrimi i thjeshtë proporcional është përdorur për secilën komunë duke u bazuar në numrin e popullsisë nëpër komuna. Poashtu numri proporcional i popullsisë për çdo grupmoshë është llogaritur për secilën komunë. Llogaritja e përqindjes së pjesëmarrjes përbëhet nga raporti mes numrit të popullsisë të regjistruar në një komunë të caktuar dhe numrit të përgjithshëm të banorëve të regjistruar në Kosovë. Përqindja e dhënë më lart përcakton përfaqësimin e secilës komunë në mostër. Referenca e popullsisë së regjistruar është marrë në të dhënat e nxjerra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Megjithatë, referenca lidhur me numrin e banorëve në veri të Kosovës është i bazuar në të dhënat e OSBE-së (Zgjedhjet, 2014).


Pyetësorët u plotësuan nëpër shtëpitë e të anketuarve dhe nëpër apartamentet e tyre. Gjatë anketimit është zgjedhur rastësisht çdo e treta shtëpi në anën e majtë të rrugës së zgjedhur. Në kompleksin banesor është zgjedhur çdo hyrje e tretë dhe pastaj një apartament në çdo të dytin kat të asaj hyrjeje. Pyetësori është administruar me vetëm 1 anëtar të familjes. Kjo është bërë që të shmanget koeficienti i paragjyqimit tek të anketuarit në mostër.

2.4. Analiza dhe prezantimi i të dhënave

Të gjitha të dhënat e mbledhura janë futur në programin statistikor SPSS prej ku janë nxjerrë analizat. Ky raport përbëhet nga statistikat përshkruese, kryqëzimit në mes të variablave: mosha, gjinia, rajoni, etniciteti dhe përmbajtjes të pyetësorit (njohuri në procesin e integritimit Evropian, të kuptuarit e procesit të integritimit Evropian, perceptimi i procesit të integritimit Evropian si një mjet për të gjeneruar zhvillim ekonomik në Kosovë, perceptimin e anëtarësimit të Kosovës në BE dhe tejkalimin e sfidave politike dhe ekonomike, perceptimin e MSA-së, perceptimin e procesit të liberalizimit të vizave). Raporti gjithashtu përmban analiza kualitative të përgjigjeve të të anketuarve të siguruara gjatë këtij hulumtimit.

2.5. Karakteristikat e mostrës

Grafiku 1: Shpërndarja e mostrës



Madhësia e mostrës është 1000 të anketuar. Shkalla e përgjigjeve të anketuarve ka qenë 100%. 53% e të anketuarve janë meshkuj; kurse 47% e të anketuarve janë femra. Mosha mesatare e të anketuarve mostrës është 36.4 vjet. Shpërndarja e mostrës në të gjithë grupmoshat është treguar në vijim:

46% e të anketuarve mostër janë të punësuar; nga të cilat, 62% janë të punësuar në sektorin privat

Shpërndarja e mostrës sipas rajonit është paraqitur mëposhtë në Grafikon 1.1




Tabela 1 paraqet numrin e popullsisë për komunë dhe numrin e të anketuarve për komunë.

Tabela 1: Madhësia e popullsisë dhe numri i intervistave për komunë

Nr.	Komuna	Popullsia	Nr i të anketuarve
1	Deçan/Dečani	40,404	22
2	Dragash/Dragaš	34,350	19
3	Ferizaj/Uroševac	109,659	60
4	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	35,222	19
5	Gjakovë/Đakovica	95,388	53
6	Gjilan/Gnjilane	90,882	50
7	Glogoc/Glogovac	59,278	33
8	Graçanicë/Grčanica	10,655	6
9	Hani i Elezit/Elez Han	9,498	5
10	Istog/Istok	39,089	22
11	Junik	6,134	3
12	Kaçanik/Kaçanik	33,780	19
13	Kamenicë/Kamenica	36,178	20
14	Klinë/Klina	38,993	22
15	Kllokot/Klokot	2,550	2
16	Leposaviq/Leposavić	13,682	8
17	Lipjan/Lipljan	58,173	32
18	Malishevë/Mališevo	55,552	31
19	Mamushë/Mamuša	5,586	3
20	Mitrovicë*/Mitrovica	72,748	40
21	Novobërdë/Novo Brdo	6,751	4
22	Obiliq/Obilić	21,782	12
23	Partesh/Parteš	1,783	1
24	Pejë/Peć	97,282	54
25	Podujevë/Podujevo	89,420	50
26	Prishtinë/Priština	200,838	111
27	Prizren	179,494	100
28	Rahovec/Orahovac	56,926	32
29	Ranillug/Ranilug	3,852	2
30	Shtërpcë/Štrpce	6,972	4
31	Shtime/Štimlje	27,515	15
32	Skenderaj/Srbica	51,480	29
33	Suharekë/Suva Reka	60,572	34
34	Viti/Vitina	47,433	26
35	Vushtrri/Vučitrn	70,536	39
36	Zveçan/Zvečan	7,421.00	4
37	Zubin Potok	14,900.00	8
38	Northern Mitrovica/Severna	12,303.00	6


	Mitrovica		
	TOTALI		1000

3. Të gjeturat

Pjesa në vijim paraqet mendimin e të anketuarve në lidhje me procesin e integritimit Evropian, MSA-së dhe liberalizimin e vizave.


Njohuri në lidhje me konceptin: procesi i integritimit Evropian

84.6% e të gjithë të anketuarve kanë dëgjuar për konceptin e procesit të integritimit Evropian. Më shumë se 80% e të anketuarve meshkuj kanë dëgjuar për nocionin: procesit i integritimit Evropian; ndërsa më shumë se 70% e femrave kanë dëgjuar për nocionin: proces i integritimit Evropian.




Në të gjitha grupmoshat, shumica e të anketuarve janë të vetëdijshëm për konceptin e integritimit Evropian. Më shumë se 80% e të gjitha grupmoshave të mostrës janë në dijeni për konceptin e procesit të integritimit Evropian.

Grafiku 3: Njohuri mbi integrimin Evropian për grupmosha



Përveç kësaj, në të gjitha rajonet, të anketuarit janë të vetëdijshëm për konceptin e integrimit Evropian. Grafiku 4 tregon se më shumë se 75% e të anketuarve për rajon janë të vetëdijshëm për konceptin përkatës.

Grafiku 4: Njohuria mbi integrimin Evropian në bazë rajonale



Në përgjithësi, ky sondazh tregon se ka një përqindje të madhe të qytetarëve të Kosovës në të gjithë 7 rajonet, të grupmoshave të ndryshme (mosha: 18-75) dhe gjinisë, të kenë njohuri mbi konceptin e procesit të integrimit Evropian.

Kuptimi i procesit të integrimit Evropian

Më tej të anketuarit janë pyetur për të përcaktuar të kuptuarit mbi konceptin e procesit të integrimit Evropian, duke përdorur opsionet e mëposhtme:

- a) Integrimi i shoqërisë Kosovare në një bashkim që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale
- b) Një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore
- c) Një njësi e bashkuar që shmang konfliktet midis vendeve që janë anëtare të Unionit dhe promovon paqe dhe marrëdhënie të mira mes vendeve fqinje
- d) Një institucion, i cili gjeneron prosperitet, mirëqenie sociale për anëtarët e saj
- e) Të tjera

Të dhënat tregojnë se shumica e të anketuarve kuptojnë procesin e integrimit Evropian ose si: a) integrimin e shoqërisë kosovare në një union që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale; ose b) një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore; ose; c) si një entitet që shmang konfliktet ndërmjet vendeve që janë anëtare të Unionit dhe promovon paqe dhe marrëdhënie të mira mes vendeve fqinje.

Në përgjithësi, Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve dhe të kuptuarit e konceptit të integrimit Evropian në kuadër të mostrës.


Tabela 2: Kuptimi i konceptit: Integrimi Evropian

Përgjigja	Përqindja
Integrimi i shoqërisë kosovare në një bashkim që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale	25.9
Një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore	33.5
Një njësi etnitet që shmang konfliktet midis vendeve që janë anëtare të unionit dhe promovon paqe dhe marrëdhënie të mira mes vendeve fqinje	29.6
Një institucion, i cili gjeneron prosperitet, mirëqenie sociale për anëtarët e saj	8.9
Të tjera	2.1

Grafiku 5 paraqet kuptimin e konceptit të integrimit Evropian në të gjitha rajonet. Rezultatet tregojnë se banorët e rajonit të Prishtinës kryesisht kuptojnë


konceptin e integrimit Evropian si *një njësi ekonomike që shmang konfliktet ndërmjet vendeve që janë anëtare të unionit dhe nxit paqen dhe marrëdhëniet e mira mes vendeve fqinje*; ndërsa banorët e rajonit të Mitrovicës e kuptojnë konceptin e integrimit Evropian si *një integrim të shoqërisë kosovare në një union që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale*.

Grafiku 5: Të kuptuarit e konceptit integrim Evropian në bazë rajonale



Grafiku 6 paraqet perceptimin e të anketuarve për procesin e integrimit Evropian nga të gjitha grupmoshat e ndryshme. 25% e të anketuarve janë të grupmoshës 18-29 vjeç; 22.5% e të anketuarve janë të grupmoshës 30-39 vjeç; 20% e të anketuarve janë të grupmoshës 40-49 vjeç; 21.7% e të anketuarve janë të grupmoshës 50-59 moshës vjeç; 15.6% e të anketuarve janë të grupmoshës 60-69 vjeç si dhe 15.38% e të anketuarve janë të grupmoshës më të vjetër 70 vjeç. Të gjitha këto grupmosha e kuptojnë konceptin e procesit të integrimit Evropian si: *integrimin e shoqërisë kosovare në një union që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale*.

Grafiku 6: Të kuptuarit e integritimit Evropian për të dy gjinitë



Përveç kësaj, 27.5% e të anketuarve të grupmoshës 18-29 vjeç; 28.2% e të anketuarve të grupmoshës 30-39 vjeç; 31.3% e të anketuarve të grupmoshës 40-49; 31% e të anketuarve të grupmoshës 50-59 vjeç; 31.2% e të anketuarve të grupmoshës 60-69 vjeç dhe 38.4% e të anketuarve të grupmoshës 70 vjeç dhe më të vjetër kuptojnë konceptin e procesit të integritimit Evropian, si: *një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore.*


Gjithashtu, 27.5% e të anketuarve të grupmoshës 18-29 vjeç; 27.1% e të anketuarve të grupmoshës 30-39 vjeç; 20% e të anketuarve të grupmoshës 40-49 vjeç; 31% e të anketuarve të grupmoshës 50-59 vjeç; 31.25% e të anketuarve të grupmoshës 60-69 vjeç dhe 38% e të anketuarve të grupmoshës më të vjetër 70 vjeç dhe më të vjetër e kuptojnë procesin e integritimit Evropian si: *Një proces që shmang konfliktet midis vendeve që janë anëtare të unionit dhe promovon paqe dhe të mirë marrëdhëniet midis shteteve fqinje.*

Për më tepër, 19.2% e të anketuarve e grupmoshës 70 vjeç dhe më të vjetër në janë përgjigjur në pyetjen përkatëse, si një kategori tjetër. Ata nuk e kuptojnë dhe përcaktojnë integritimin Evropian nga opsionet e ofruara. Megjithatë, në këtë rast nuk kanë ofruar ndonjë përkufizim të konceptit të procesit të integritimit Evropian.

Përveç kësaj, të dhënat tregojnë se meshkujt të përfshirë në këtë mostër perceptojnë procesin e integritimit Evropian më shumë si *një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore*; ndërsa të anketuarit femra perceptojnë procesin e integritimit Evropian në mënyrë të barabartë sikurse meshkujt, pra, si: *një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore*; por edhe; *si një entitet që shmang konfliktet ndërmjet vendeve që janë anëtare të unionit dhe promovon paqe dhe marrëdhënie të mira mes vendeve fqinje*.


Përfitimet e Procesit të Integritimit Evropian

84.9% e të anketuarve perceptojnë se Kosova përfiton nga procesi i integritimit Evropian. Grafiku 7 tregon se shumica e të anketuarve të të gjitha grupmoshave perceptojnë se Kosova përfiton nga procesi i integritimit Evropian.



Megjithatë, 3.3% e të anketuarve perceptojnë se Kosova humb nga procesi i integrimit Evropian. 10.5% e të anketuarve nuk i dijnë përfitimet e Kosovës ose humbjet nga procesi i integrimit Evropian. Për më tepër, 1.3% e të anketuarve konsiderojnë se Kosova ka përfitime edhe humbje nga procesi i integrimit Evropian.


Grafiku 8: Benefitet / humbjet e Kosovës nga integrimi Evropian dhe perspektiva gjinore



Madje, si meshkujt ashtu edhe femra kanë shprehur në mënyrë të konsiderueshme që Kosova ka përfitime nga procesi i integrimit Evropian. Më pak se 2% të të anketuarve si meshkujt ashtu edhe femrat janë përgjigjur në opcionin: të tjera;

ndërsa po këta kanë konsideruar se Kosova do të ketë përfitime edhe humbjet nga procesi i integrimit Evropian. Për më tepër, Grafiku 9 tregon se në të

Grafiku 9: Perceptimi i benefiteve të integrimit Evropian nëpër rajone



gjitha rajonet e Kosovës, të anketuarit kanë një perceptim se Kosova do të përfitojë nga procesi i integrimit Evropian.

Përfitimet dhe humbjet nga procesi i integrimit Evropian

Të anketuarit janë pyetur për të shprehur perceptimin e tyre nëse Kosova përfiton në procesin para dhe pas integrimit Evropian. Tabela e mëposhtme tregon kategoritë e përgjigjeve;

Tabela 3: Përfitimet gjatë dhe pas procesit të integrimit Evropian


Kategoria e përgjigjes	Përfitimet gjatë procesit të integrimit Evropian	Përfitimet pas procesit të integrimit Evropian
Zhvillimi ekonomik	40%	30%
Lëvizja e lirë / Liberalizimi i visave	40%	35%
Shkëmbim në arsim	//	2%
Zhvillimi i rinisë	//	2%
Lehtësi në tregti	20%	15%
Shkëmbim kulturor / Zhvillim	//	1%
Punësim në BE	//	15%

Kryesisht, ky sondazh ka gjetur se numri më i madh i qytetarëve të Kosovës percepton se Kosova do të përfitojë nga procesi i integrimit Evropian. Konkretisht, sondazhi gjen se qytetarët e Kosovës të të gjithë grupmoshave (varg mosha: 18-75), nga 7 rajone dhe nga të dyja gjinitë, shohin se Kosova do të përfitojë nga integrimi Evropian. Megjithatë, ka një ndryshim në perceptimin e përfitimeve që Kosova do të ketë gjatë dhe pas procesit të integrimit Evropian. Përfitimet e perceptuara gjatë procesit të integrimit Evropian janë të grumbulluara në fushat e mëposhtme: zhvillim ekonomik; lëvizje e lirë / liberalizim i vizave dhe kushte më të favorshme për tregtinë. Edhe pse, përfitimet e perceptuara pas integrimit Evropian kanë qenë të ndara në një numër të madh të grupeve, siç janë: zhvillimi ekonomik, lëvizja e lirë /

liberalizim i vizave; kushte më të favorshme për tregtinë; punësim në BE; këmbim në arsim, zhvillimi i të rinjve si dhe përfitimet e këmbimit / zhvillimit kulturor.

Procesi i integrimit Evropian, si një metodë e normalizimit të marrëdhënieve me shtetin fqinj, Serbinë


Për më tepër, sondazhi ka matur perceptimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me procesin e integrimit Evropian, si një metodë për normalizimin e marrëdhënieve me shtetin fqinj, Serbinë. Më pak se gjysma e mostrës, përkatësisht, 47.1% e të gjithë të anketuarve perceptojnë se Kosova mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian. Gjithashtu, 27% e të anketuarve kanë deklaruar se Kosova nuk mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian. Dhe 20.1% e të anketuarve nuk e dijnë nëse Kosova mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian. Vargu përkatës i përqindjeve mund të vërehet në të gjitha grupmoshat, *shiko Grafikon 10*.




Në mënyrë të ngjashme, ky sondazh gjen se rreth 45% e të anketuarve meshkuj dhe rreth 35% e të anketuarve femra perceptojnë se Kosova mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian.

Për më tepër, Grafiku 11 tregon perceptimin e të anketuarve që procesi i integritimit Evropian për Kosovën është mjet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Grafiku 11: Rajoni / integrimi evropian / normalizimi i marrëdhënieve



Grafiku 11.1 Rajoni i Mitrovicës / integrimi Evropian / normalizimi i marrëdhënieve




Kjo mund të vërehet në grafikun 11 që një numër mbi mesatar i të anketuarve në 6 rajonet e Kosovës, si: Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë dhe rajonin e Prizrenit, perceptojnë se, Kosova mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian. Në të kundërtën, të anketuarit nga rajoni i Mitrovicës perceptojnë se Kosova nuk mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian. Për këtë arsye, një analizë më e hollësishme tregon dallimin e etnik në perceptimin e integrimit Evropian si një mjet për Kosovën për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Grafiku 11.1 tregon se etnia shqiptare në rajonin e Mitrovicës percepton që Kosova nuk mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian. Përderisa etnia serbe në rajonin e Mitrovicës kryesisht nuk e din nëse Kosova mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë nëpërmjet procesit të integrimit Evropian.

Në përgjithësi, është një numër mbi mesatar i qytetarëve të Kosovës nëpër 6 rajonet e saj, të cilët e perceptojnë se Kosova mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë. Megjithatë, etnia shqiptare në rajonin e Mitrovicës, percepton se Kosova nuk mund të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përmes procesit të integrimit Evropian.

Integrimi Evropian dhe zhvillimi ekonomik


81% e të gjithë të anketuarve perceptojnë se procesi i integrimit Evropian mund të gjenerojnë zhvillim ekonomik për Kosovën. Numri më i madh i të anketuarve (mbi 70%) të të gjitha grupmoshave të mostrës perceptojnë se procesi i integrimit Evropian mund të gjenerojnë zhvillim ekonomik për Kosovën.



Përveç kësaj, shumica e të anketuarve në të gjithë 6 rajonet e Kosovës, e perceptojnë se procesi i integrimit Evropian mund të gjenerojë zhvillimin ekonomik. Megjithatë, Grafiku 13 tregon se shpërndarja e përgjigjeve / perceptimeve në rajonin e Mitrovicës ndryshon nga të 6 rajonet e tjera.


Në rajonin e Mitrovicës, rreth 35% e të anketuarve perceptojnë

Grafiku 13: Rajoni / integrimi Evropian / zhvillim ekonomik



se procesi i integrimit Evropian nuk do të çojë në zhvillimin ekonomik; 35% e perceptojnë se procesi i integrimit Evropian do të çojë në zhvillimin ekonomik; më shumë se 20% janë përgjigjur që nuk e dijnë nëse procesi i integrimit Evropian do të çojë në zhvillimin ekonomik. Në një analizë të mëtejshme, Grafiku 13.1

Grafiku 13.1. Mitrovica / integrimi Evropian / zhvillimi ekonomik



tregon

perceptimin e etnive shqiptare dhe serbe në drejtim të procesit të integrit Evropian, si një metodë për të gjeneruar zhvillim ekonomik në Kosovë.


Rreth 38% e të anketuarve etnike shqiptarë perceptojnë se procesi i integrit Evropian mund të gjenerojnë zhvillim ekonomik në Kosovë, ndërsa 34% e tyre e perceptojnë se procesi i integrit Evropian nuk mund të gjenerojë zhvillim ekonomik në Kosovë dhe 28% e tyre nuk e dijnë nëse procesi i integrit Evropian mund të gjenerojnë zhvillim ekonomik në Kosovë. Nga ana tjetër, 27% e të anketuarve etnik serbë perceptojnë se procesi i integrit Evropian mund të gjenerojë zhvillim ekonomik në Kosovë; rreth 10% e perceptojnë se procesi i integrit Evropian nuk mund të gjenerojë zhvillim ekonomik në Kosovë; dhe 34% nuk e dijnë nëse procesi i integrit Evropian mund të gjenerojnë zhvillim ekonomik në Kosovë. 29% e tyre kanë shprehur perceptimin e tyre tek opsioni “të tjera”. “Të tjetra” pasqyron: se zhvillimi ekonomik i Kosovës mund të gjenerohet si një kombinim i zhvillimit lokal të politikave dhe proceseve si dhe procesit të integrit Evropian.

Në përgjithësi, ky sondazh tregon se numri më i madh i qytetarëve të rajoneve të Kosovës: Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajit perceptojnë se procesi i integrit Evropian mund të gjenerojë zhvillim ekonomik për Kosovën. Megjithatë, në rajonin e Mitrovicës, veçanërisht të anketuarit e etnisë shqiptare pothuajse në mënyrë të barabartë e perceptojnë se integrimi Evropian mund dhe nuk mund të gjenerojë zhvillim ekonomik në Kosovë.

Anëtarësimi në BE dhe Sfidat Politike

45.6% e të gjithë të anketuarve perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian mund të shërbejë si një mjet për tejkalimin e sfidave politike të Kosovës. Megjithatë, 18% e të gjithë të anketuarve nuk e dijnë nëse


Grafiku 14: Anëtarësimi në BE dhe sfidat politike të Kosovës



anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian mund të zgjidhë sfidat politike të Kosovës. Perceptimet e sipër përmendura janë paraqitur tek të gjitha grupmoshat e mostrës.


Në përgjithësi, në të gjithë rajonet e Kosovës, përveç për rajonin e Mitrovicës, shumica e të anketuarve perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë Kosovën në tejkalimin e sfidave politike. Megjithatë, shumica e të anketuarve të rajonit të Mitrovicës mendojnë që anëtarësimi i Kosovës në Bashkim Evropian as s'do të mbështesë as nuk të çojë në tejkalimin e sfidave politike.

Grafiku 15: Anëtarësimi i Kosovës në BE / sfidat politike/ perspektiva rajonale



Më tepër, Grafiku 15.1 tregon dallimet në perceptimin e komunitetit shqiptar dhe serb në rajonin e Mitrovicës drejt anëtarësimit të Kosovës në BE, si një zgjidhje për sfidat politike të Kosovës. Siç mund të shihet në grafikun 15.1, një numër i madh i konsiderueshëm i të anketuarve etnik shqiptarë

Grafiku 15.1. Anëtarësimi i Kosovës në BE / sfidat politike / Mitrovica



perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në Bashkim Evropian do të çojë në zgjidhjen e sfidave politike të Kosovës.


Në përgjithësi, shumica e të anketuarve nga 6 rajonet e Kosovës, përveç në rajonin e Mitrovicës, shohin që anëtarësimi i Kosovës në Bashkim Evropian (BE) do të çojë në zgjidhjen e sfidave politike të Kosovës. Është një perspektivë e ndryshme në rajonin e Mitrovicës ku të anketuarit etnisë shqiptare perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE nuk do të çojë në zgjidhjen e sfidave politike të Kosovës

Anëtarësimi në BE dhe Sfidat Ekonomike

67.5% e të gjithë të anketuarve perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian do të shërbejë si një metodë për të tejkaluar sfidat ekonomike të Kosovës. Grafiku i dhënë 11, tregon se perceptimi i anëtarësimit të Kosovës në BE i cili do të shërbejë si një mjet për të tejkaluar sfidat ekonomike,

është i përhapur në mënyrë të barabartë në të gjitha grupmoshat e mostrës.


Grafiku 16: Anëtarësimi i Kosovës në BE / sfida ekonomike / grupmosha



13.3% e të anketuarve mostër perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian nuk do të shërbejë si një mjet për të tejkaluar sfidat ekonomike. Megjithatë, 13.9% e të anketuarve nuk e dijnë nëse anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian do të shërbejë si një mjet për të tejkaluar sfidat ekonomike.

Shumica e të anketuarve në 6 rajonet e Kosovës kanë deklaruar se ata e perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE do të shërbejë si një mjet për të tejkaluar sfidat ekonomike të Kosovës. Më shumë se 20% e të anketuarve të rajonit të Mitrovicës shohin se anëtarësimi i Kosovës në BE nuk do të shërbejë si një mjet për të tejkaluar sfidat ekonomike. Rreth 30% janë të sigurt që anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë Kosovën për të tejkaluar sfidat ekonomike, dhe më shumë se 40% nuk e dijnë nëse anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë Kosovën për të tejkaluar sfidat ekonomike.

Grafiku 17: Anëtarësimi i Kosovës / sfida ekonomike / rajoni




Gjithashtu, 55% e të anketuarve të punësuar dhe rreth 56% e të anketuarve të papunë, perceptuan që anëtarësimi i Kosovës në BE mund të mundësojë Kosovën të tejkalojë sfidat ekonomike.

Përgjithësisht, një numër i madh i qytetarëve të Kosovës perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë Kosovën në zgjidhjen e sfidave e saj ekonomike. Në gjashtë rajone, shumica e të anketuarve perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë atë në zgjidhjen e sfidave e saj ekonomike. Përderisa, në rajonin e Mitrovicës perceptimi është i përhapur në mënyrë të barabartë, ashtu që: a) anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë atë në tejkalimin e sfidave ekonomike; b) anëtarësimi i Kosovës në BE nuk do të mbështesë atë në tejkalimin e sfidave ekonomike; dhe c) nuk e di nëse anëtarësimi i Kosovës në BE do të mbështesë atë në tejkalimin e sfidave ekonomike.


Shpejtësia e procesit të integritimit Evropian

73.6% e të gjithë të anketuarve perceptojnë se procesi i integritimit Evropian i Kosovës është duke u zhvilluar ngadalë. 15.9% e të anketuarve perceptojnë se procesi përkatës është duke u zhvilluar me një ritëm normal. Megjithatë, vetëm 3% e të anketuarve

perceptojnë se procesi përkatës është duke u zhvilluar me një ritëm të shpejtë. Perceptimi përkatës është i njëjtë në të gjitha grupmoshat; *shih Grafikon 18.*



Në mënyrë të ngjashme, perceptimi i të anketuarve që procesi i integrimit Evropian është duke u zhvilluar me një ritëm të ulët është i pranishëm në të gjitha rajonet e Kosovës, shiko grafikun 19.



Kështu që në përgjithësi, shumica e të anketuarve në Kosovë e perceptojnë se procesi i integrimit Evropian i Kosovës është duke u zhvilluar me një ritëm të ngadaltë. Perceptimi përkatës është i dukshëm në të gjitha grupmoshat (mosha: 18-75); gjinitë dhe rajonet.

Mjetet e marrjes së informacionit për procesin e integrimit Evropian

Tabela e dhënë më poshtë, Tabela 4, tregon shpërndarjen e mjeteve përmes të cilit të anketuarit marrin informacione mbi procesin e integrimit Evropian. Nga kjo tabelë mund të vërehet se lajmet, portalet dhe mediat të tjera të shkruara janë tri mjetet kryesore përmes të cilave të anketuarit marrin informacione në lidhje me procesin e integrimit Evropian.


Mjeti	Përqindja
Lajmet në TV	50.5
Debatet	5.2
Portalet	14.2
Mediat e tjera të shkruara	15.0
Rrjeti im	3.0
Të tjera	2.1
Më shumë se një mjet	10.0

Tabela 4: Si merrni informacion mbi procesin e integrit Evropian?


Perceptimet për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe përfitimet e saj

59.1% e të anketuarve kanë dëgjuar se Kosova ka nënshkruar MSA-në (Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit); ndërsa 40.7% e të anketuarve nuk kanë dëgjuar për marrëveshjen përkatëse. Perceptimi përkatës është i shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha grupmoshat dhe rajonet në Kosovë; *shih Grafi 20 dhe 21.*

Grafiku 20: MSA dhe grupmosha



Grafiku 21: MSA dhe rajoni



Përveç kësaj, nga 59.1% e të anketuarve të cilët janë të vetëdijshëm se Kosova ka nënshkruar MSA-në, vetëm 34.9% dijnë përfitimet e Kosovës nga MSA; ndërsa më shumë se 60% kanë deklaruar se nuk e dijnë nëse Kosova do të përfitojë nga MSA-ja. Përfitimet e perceptuara nga MSA-ja janë: a) zhvillimi ekonomik dhe b) një potencial më të madh për bizneset që të bashkëpunojnë me vendet e Bashkimit Evropian, apo të eksportojnë produktet dhe shërbimet e tyre në vendet e Bashkimit Evropian.

Tabela 5 tregon mjetet e informimit për MSA-në. Nga të dhënat e kësaj table mund të vërehet se shumica e të anketuarve kanë marrë informacion në lidhje me MSA-së me anë të lajmeve televizive.

Tabela 5: Si e keni marrë informacione në lidhje me MSA-në?

Mjeti	Përqindja
Lajme në TV	60%
Portalet	25%
Mediat e tjera të shkruara	10%
Rrjetizimi	5%

Atëherë në përgjithësi, ky sondazh ka gjetur se një numër mesatar i qytetarëve janë të vetëdijshëm për konkluzionet e MSA-së dhe përfitimet e saj në Kosovë. Rezultatet tregojnë se lajmet në televizion janë një nga mjetet më të përdorura për të marrë informacion mbi MSA-në; kështu që ka mundësi të zgjerohen mjetet e informimit mediatic, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi rreth MSA-së dhe përfitimeve të saj në mesin e qytetarëve të Kosovës.

Procesi i liberalizimit të vizave

Tabela 6 tregon perceptimin e të anketuarve në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave. 60.5% e tyre e perceptojnë se procesi i liberalizimit të vizave ka të bëjë me lëvizjen e lirë të qytetarëve në Zonën Schengen.

Tabela 6: Perceptimi i liberalizimit të vizave

Perceptimi	Përqindja
Lëvizja e lirë në të gjitha vendet e BE-së	26.1
Lëvizja e lirë në zonën Schengen	60.5
Lëvizja e lirë në BE dhe Ballkanin Perëndimor	1.8
Lëvizja e lirë në Zonën e BE-së	11.6


Përveç kësaj, 73% e të anketuarve janë shprehur se lëvizja e lirë në zonën Schengen është përfitimi i procesit të liberalizimit të vizave; kurse 14% e tyre janë shprehur se liberalizimi i vizave do të mundësojë atyre që të punësohen në vendet e BE. Tabela 7 tregon proporcionin e përfitimeve të perceptuara nga ana e të anketuarve.

Tabela 7: Përfitimet nga liberalizimi i vizave


Përfitimet	Përqindja
Lëvizja e lirë në zonën Schengen	73.0
Punësimi në vendet e BE-së	14.0
Mundësi për të qëndruar në zonën Schengen për një periudhë të pacaktuar kohore	4.6
Mundësi për bashkim familjar	6.0
Tjetër	2.3

Grafiku 22 tregon proporcionin e perceptimit të përfitimeve të integritimit Evropian tek të gjithë grupmosha në mostër. Këtu mund të theksohet se perceptimi përkatës është i shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha grupmoshat.

Grafiku 22: Liberalizimi i Vizave dhe grupmosha




Gjithashtu, Grafiku 23 tregon se në të gjitha rajonet e Kosovës, shumica e të anketuarve kanë shprehur që lëvizja e lirë në zonën Schengen është një përfitim nga procesi i liberalizimit të vizave.



Përveç kësaj, shumica e të anketuarve saktë perceptojnë se liberalizimi i vizave ka të bëjë me

lëvizjen e lirë në zonën Schengen. Por, një përqindje më e madhe e të anketuarve të papunë (rreth



20%), në krahasim me ata të punësuar (rreth 8%) të anketuarve, e shohin liberalizimin e vizave si një mënyrë për t'u punësuar në vendet e BE-së.


Për më tepër, 78.9% e të gjithë të anketuarve kanë deklaruar nëse procesi i liberalizimit të vizave do të bëhet, atëherë një person mund të qëndrojë në zonën Schengen për 90 ditë brenda 6 muajve. Mendimi përkatës u shpreh në mënyrë të barabartë në të gjitha grupmoshat.


Tabela 8: Kohëzgjatja e qëndrimit në Zonën Schengen - Liberalizimi i vizave

Kohëzgjatja	Përqindja
90 ditë deri në 6 muaj	78.9
180 ditë brenda 1 viti	11.4
Periudhë e pakufizuar	5.8
Tjetër	3.9

Përveç kësaj, shumica e të anketuarve të të gjithë grupmoshave dhe rajoneve në Kosovë (*shiko Grafikon 25 dhe 26*), saktë perceptojnë, se procesi i liberalizimit të vizave u mundëson atyre që të qëndrojnë 90 ditë brenda një periudhe prej 6 muajve.

Grafiku 25: Liberalizimi i vizave dhe qëndrimi në Zonën Schengen në grupmosha





Përgjithësisht, ky sondazh tregon se një numër mbi mesatar i qytetarëve saktë e perceptojnë procesin e liberalizimit të vizave. Poashtu, një numër i konsiderueshëm saktë percepton se përfitimi i liberalizimit të vizave mundëson lëvizjen e lirë në vendet e zonës Schengen. Perceptimi i sipër përmendur në të gjitha rajonet e Kosovës, grupmoshat (varg mosha: 18-75) dhe gjinitë. Megjithatë, një pjesë më e madhe e qytetarëve të papunë perceptojnë liberalizimin e vizave si një metodë për të marrë punë në vendet e BE-së.

4. Konkluzionet dhe rekomandimet

Përfundimet e sondazhit e perceptimit të opinionit publik mbi integritin

Evropian janë si më poshtë:

- ❖ 84.6% e të gjithë të anketuarve kanë dëgjuar për konceptin e integritit Evropian. Për këtë arsye, ne mund të përgjithësojmë se banorët e Kosovës janë të vetëdijshëm për konceptin e integritit Evropian. Ky hulumtim tregon se lajmet në TV janë mjet përmes të cilit pjesa më e madhe e banorëve marrin informacione në lidhje me integritin Evropian. Mjetet tjera të informimit janë: portalet dhe mediat tjera të shkruara.
- ❖ Ka një dallim në të kuptuarit e asaj se ma çka ka të bëjë koncepti i integritit Evropian.

Perceptimet më të zgjedhura janë:

I pari më i zgjedhur: Një union, organizatë që përfaqëson demokracitë më të zhvilluara perëndimore

I dyti më i zgjedhur: Një njësi ekonomike që shmang konfliktet midis vendeve që janë anëtare të unionit dhe promovon paqen dhe marrëdhëniet e mira mes vendeve fqinje

I treti më i zgjedhur: Integriti i shoqërisë kosovare në një bashkim që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale

Megjithatë, ka një ndryshim të perceptimit të procesit të integritit Evropian në rajonin e Mitrovicës. Në Mitrovicë, të kuptuarit e integritit Evropian është: integriti i shoqërisë kosovare në një bashkim që përbëhet nga vlera krejtësisht të ndryshme nga vlerat tona tradicionale. Ndërsa në të 6 rajonet e tjera të Kosovës, përkufizimi i tretë është më i zgjedhur.

- ❖ Pjesa më e madhe e të anketuarve e kanë kuptuar se Kosova përfiton nga procesi i integritit Evropian. Përfitimet e perceptuara gjatë procesit të integritit Evropian janë kryesisht të lidhura me zhvillimin ekonomik; lëvizjen e lirë dhe kushtet më të favorshme për tregtinë. Ndërsa, përfitimet e perceptuara pas procesit të integritit Evropian ndërlidhen me: zhvillimin ekonomik, lëvizjen e lirë, kushte më të favorshme për tregti, punësim në BE, shkëmbim në arsim, zhvillimin e të rinjve si dhe zhvillimin kulturor. Megjithatë, më shumë se 70% e të anketuarve nëpër të gjitha rajonet e Kosovës e perceptojnë se procesi i integritit Evropian të Kosovës është duke u zhvilluar më ritëm të ngadaltë.
- ❖ Prosesi i integritit Evropian perceptohet në mënyrë të moderuar në 6 rajone të Kosovës, si një mjet për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërtën, qytetarët e Mitrovicës, veçanërisht nga komuniteti shqiptar, shumica e perceptojnë se procesi i integritit Evropian nuk mund të mbështesë Kosovën në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.
- ❖ Anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian është perceptuar nga një numër mesatar i të anketuarve (45.6%), si një mjet për të kapërcyer sfidat politike dhe nga numri më i madh i të anketuarve (67.5%), si një mjet për tejkalimin e sfidave ekonomike në Kosovë. Ky sondazh tregon se anëtarësimi në BE është perceptuar kryesisht si një mjet për të kapërcyer sfidat ekonomike sesa si një mjet për tejkalimin e sfidave politike të Kosovës. Vlen të përmendet se qytetarët e rajonit të Mitrovicës, në mënyrë të veçantë pjesa më e madhe e etnisë shqiptare, perceptojnë se sfidat politike të Kosovës nuk mund të zgjidhet me anë të anëtarësimit të Kosovës në BE.
- ❖ Një numër pak më i lartë se gjysma e mostrës (59.1% e të anketuarve), është e vetëdijshme se Kosova ka nënshkruar MSA-në; por vetëm 30% e të anketuarve të cilët janë në dijeni të MSA-së do të mund të bëjnë lidhjen

me përfitimet e saj. Përfitimet e perceptuara janë në aspektin e mundësive të tregtisë të lirë për komunitetin e biznesit dhe zhvillimin ekonomik. Lajmet në TV janë mjet kryesor për të marrë informacion në lidhje me MSA-së; dhe pastaj mjetet tjera informuese janë portalet dhe media të tjera të shkruara.

- ❖ Më shumë se 60% e të anketuarve perceptojnë konceptin e liberalizimit të vizave si një metodë për të lëvizur lirshëm në vendet që janë në Zonën Schengen. 73% perceptojnë që një nga përfitimet e liberalizimit të vizave është lëvizja e lirë në vendet e zonës Schengen. Megjithatë, 20% e të anketuarve të papunë të mostrës perceptojnë procesin e liberalizimit të vizave si një metodë për t'u punësuar në vendet e BE. 78.9% e të anketuarve perceptojnë saktë kohëzgjatjen e qëndrimit në Zonën Schengen përmes procesit të liberalizimit të vizave.

Në përgjithësi, ky sondazh paraqet perceptimet e qytetarëve të Kosovës dhe të kuptuarit e procesit të integritit Evropian dhe ndikimet e tij. Kështu, sondazhi tregon se qytetarët e Kosovës kanë dëgjuar për idenë e integritit Evropian. Ka dallime në të kuptuarit se çfarë do të thotë koncepti përkatës. Përveç kësaj, ky hulumtim tregon se qytetarët pozitivisht perceptojnë se integrimi Evropian mund të mbështesë Kosovën në gjenerimin e zhvillimit ekonomik. Poashtu ky hulumtim tregon se një numër i moderuar i qytetarëve nëpër 6 rajonet e Kosovës, por një numër i vogël i etnisë shqiptare në Mitrovicë, perceptojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE mund të mbështesë Kosovën në zhvillimin ekonomik. Gjithashtu, ky sondazh tregon se vetëm një numër mesatar i qytetarëve perceptojnë se procesi i integritit Evropian mund të çojë në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Dhe kjo gjithashtu tregon se anëtarësimi i Kosovës në BE nuk mund të mbështesë Kosovën në tejkalimin e sfidave të saj politike. Kështu, në përgjithësi, integrimi Evropian dhe anëtarësimi në BE shihen në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe jo në tejkalimin e sfidave politike.

Përveç kësaj, ky hulumtim tregon se vetëm një numër mesatar i qytetarëve janë të vetëdijshëm se Kosova ka nënshkruar MSA-në, dhe një numër shumë i vogël i qytetarëve janë të vetëdijshëm për përfitimet e saj. Megjithatë, një numër i madh i qytetarëve e dinë saktë se procesi i liberalizimit të vizave ka të bëjë me lëvizjen e lirë në zonën Schengen për një periudhë të caktuar kohore.

Për më tepër, është e qartë se lajmet në TV janë mjete më të përdorur për të marrë informacione mbi liberalizimin e vizave, integrimin Evropian dhe MSA-në. Qytetarët e Kosovës marrin informacione në mënyrë pasive dhe nuk janë të angazhuar në mënyrë aktive.

Kështu, në bazë të anketës të realizuar, rekomandohet që:

- ❖ Qeveria e Kosovës duhet të informojë qytetarët në lidhje me integrimin Evropian, nëpërmjet komunikimeve tjera aktive që do të thotë: konferenca, debate aktive, fushata të vetëdijësimit, dhe nuk duhet të lejojë që lajmet, si një mjet pasiv i komunikimit, të jetë mjeti i vetëm i informacionit;
- ❖ Qeveria e Kosovës duhet të marrë në konsideratë perceptimin e qytetarëve etnik shqiptar të Mitrovicës, perceptimet e të cilëve ndryshojnë nga perceptimet e qytetarëve të rajoneve të tjera. Ky sondazh ka reflektuar perceptimet, dyshimet dhe pasiguritë që komunitetit shqiptar në rajonin e Mitrovicës i përjeton. Për këtë arsye, institucionet qeveritare duhet të kenë një komunikim më të drejtpërdrejtë dhe të hapur me qytetarët përkatës, për të kapërcyer gjendjen e tanishme të tyre;
- ❖ Qeveria e Kosovës duhet të hartojë një plan veprimi me kombinim të masave afatshkurtëra dhe afatgjate. Masa afatshkurtëra janë: informim publik dhe fushatat ndërgjegjësuese; dhe masat afatgjate janë: përmirësimi i kushteve të jetesës tek grupet e cënueshme të popullsisë dhe të njerëzve të papunë në mënyrë që ata plotësisht të kuptojnë procesin e liberalizimit të vizave;

- ❖ Qeveria e Kosovës që nga fillimi i fushatës informuese të synuar (në veçanti në lidhje me përfitimet e MSA-së dhe çështjen e liberalizimit të vizave), duhet të përfshijë organizatat rinore dhe OJQ, si dhe partitë e pakicave dhe udhëheqësit e tyre;
- ❖ Në mënyrë të ngjashme, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje shtesë për të punuar më ngushtë me të dy etnitë në rajonin e Mitrovicës, dhe duhet t'i bindin ata se integrimi Evropian është një mjet që do të stimulojë integrimin e qytetit të tyre; si dhe
- ❖ Së fundi, për qytetarët e Kosovës duhet të bëhet më shumë punë dhe është i nevojshëm sqarimi i mëtutjeshëm i konceptit të procesit të integritit Evropian në përgjithësi, si dhe idesë të Bashkimit Evropian, në veçanti.

Aneksi 1: Pyetësi

Data: _____ **Ora:** _____ **Intervistues:** _____ **Kodi:** _____

Instituti Ridea me mbështetjen e UNDP bën hulumtimin në matjen e perceptimeve të opinionit publik për procesin e Integritimit Evropian. Ju jeni përzgjedhur rastësisht për pjesëmarrje. Të dhënat tuaja do të mbesin konfidenciale.

Komuna

Gjinia	M	F	Mosha
A jeni të punësuar	PO	JO	Nëse po: në cilin sektor:

1. A keni dëgjuar për konceptin: Integrim Evropian

PO _____ JO _____

Nëse PO kaloni në pyetjen 2, nëse jo, kaloni në pyetjen 12

2. Si e kuptoni procesin e Integritimit Evropian

- f) Integrim i shoqërisë kosovare në një union, që përbëhet prej vlerave që janë krejtësisht ndryshe nga vlerat tona tradicionale
- g) Një union, organizatë që përfaqëson vlerat e një shoqërie të zhvilluar demokratike
- h) Një proces që shmang konfliktet në mes shteteve që janë anëtarë të këtij unioni dhe që promovon paqe dhe marrëdhënie të mira ndërmjet shteteve fqinje
- i) Një institucion, që gjeneron prosperitet dhe mirëqenie për anëtarët e saj
- j) Tjetër: _____

3. Cilat mendoni se janë benefitet e Kosovës gjatë procesit të integritimit Evropian

4. Cilat mendoni se janë benefitet pas procesit të integritimit Evropian?

5. A mendoni që Kosova

- a) përfiton nga integrimi Evropian
- b) humb nga integrimi Evropian
- c) Nuk e di
- d) Tjetër _____

6. A mendon që Kosova mund t'i normalizojë marrëdhëniet e saja me Serbinë, nëpërmjet procesit të integritimit Evropian?

- a) PO
- b) JO
- c) Nuk e di
- d) Tjetër _____

7. A mendoni që procesi i integritit Evropian gjeneron zhvillim ekonomik?

- a) PO
- b) JO
- c) Nuk e di
- d) Tjetër _____

8. A mendoni që anëtarësimi në Bashkim Evropian do të zgjidh sfidat tona politike?

- a) PO
- b) JO
- c) Nuk e di
- d) Tjetër _____

9. A mendoni që anëtarësimi i Kosovës në Bashkim Evropian do të zgjidh sfidat ekonomike?

- e) PO
- f) JO
- g) Nuk e di
- h) Tjetër _____

10. A mendoni që procesi i integritit Evropian i Kosovës po zhvillohet?

- a) shpejtë
- b) ngadalë
- c) normalisht
- d) Nuk e di
- e) Tjetër _____

11. Si pranoni informacione për procesin e integritit Evropian të Kosovës?

- a) Lajme
- b) Debate
- c) Portale
- d) Media tjera të shkruara
- e) Diskutime me rrjetin tim (shoqëri, kolegë, familjar)
- f) Tjetër _____

12. A jeni të informuar se Kosova ka nënshkruar MSA (Marrëveshje për Stabilizim -Asociim)?

PO _____ JO _____
Nëse po, si? _____

13. A mendoni që Kosova përfiton nga MSA?

- a) PO. Cilat janë benefitet _____
- b) JO
- c) Nuk e di

14. Çka mendoni se nënkupton procesi i liberalizimit të vizave?

- a) Lëvizje e lirë në të gjitha shtetet e BE
- b) Lëvizje e lirë në zonën schengen
- c) Lëvizje e lirë në shtetet e BE dhe Ballkanit Perëndimor
- d) Lëvizje e lirë në zonën Evropiane

15. Çka mendoni, cilat janë përfitimet nga liberalizimi i vizave ?

- a) Lëvizje e lirë në zonën schengen
- b) Punësim në shtetet e BE
- c) Mundësi për qëndrim në Zonën Schengen pa afat kohor
- d) Mundësi për bashkim familjar
- e) Tjetër _____

16. Sa gjatë mund të qëndrojë një person në zonën Schengen, nëse bëhet liberalizimi i vizave për Kosovën:

- a) 90 ditë brenda 6 muajve
- b) 180 ditë brenda 1 viti
- c) Periudhë e pacaktuar
- d) Tjetër _____

Ju lutem jepni informacionet e mëposhtme. Këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllim të këtij sondazhi dhe do të mbahen konfidenciale.

Emri dhe Mbiemri _____

Email: _____

Nr Tel: _____